

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nëse avokatët reagojnë për telefonat, pse heshtin për të drejtat e të pandehurve?
ADRESA	https://piranjat.al/editorial/nese-avokatet-reagojne-per-telefonat-pse-heshten-per-te-drejtat-e-te-p-i103198
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 10:30:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 10:14:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	574307cf5c9c7fdb02032920c732848dd96380e462b11861b211c5596949c0e5
TEKSTI	548e7633f27157d986c3752d5a12f5c619da888911c8995ac5112d98bf634094
PAMJA	ebeee311bc798d1114e5ce51c05d731b3a6dfff367c511b6108aa4ad21f3e6bf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5266ec561014304a9cbd620cd0c25efeec2c61889e6ec430843dcc59ab72e2e2
E MËPARSHMJA	9022cbc4b805a5f8a3e8b41ec0a48cd1a6ba3852dcb4c72751d8d06914eebe8d
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5266ec561014304a9cbd620cd0c25efeec2c61889e6ec430843dcc59ab72e2e2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

[përleshje
mes policisë](#)

[në Brazil
shkakton](#)

[partnerëve
të Elon](#)

[dhe, me
siguri,
edhe më](#)



EDITORIAL

Nëse avokatët reagojnë për telefonat, pse heshtin për të drejtat e të pandehurve?

Ilir Beqaj Përditësimi i fundit 9 Shtator 2026, 12:14



Reagimin e Dhomës së Avokatisë ndaj kufizimit të përdorimit të telefonave celularë në GJKKO e konsideroj të kuptueshëm. Avokatët kundërshtojnë një pengesë në ushtrimin e profesionit dhe një trajtim që e konsiderojnë të pabarabartë në raport me organin e akuzës. Shqetësimi i tyre meriton të dëgjohet.

Por, si një person që prej tre vjetësh përballem me procese penale në GJKKO, unë e shoh problemin edhe nga një këndvështrim tjetër. Për mua, më shumë sesa prania e telefonit celular të avokatit në sallë, rëndësi ka nëse ai mund të ketë me vete kompjuterin portabel. Një dosje prej 250 mijë faqesh është praktikisht e pamundur për t'u konsultuar nga ekrani i telefonit gjatë një seance. Duhet të gjejsh dokumentin, ta lexosh, ta krahasosh me një tjetër dhe të reagoosh ndaj asaj që po thuhet në sallë.

Nuk kërkoj përjashtim nga rregullat e sigurisë. Kërkoj që organizimi i sigurisë të mos e bëjë të pamundur mbrojtjen reale, mbrojtjen efektive. Nëse përdorimi i një pajisjeje elektronike duhet kufizuar, duhet të sigurohet një mënyrë tjetër, realisht funksionale, për të punuar me dosjen. Përndryshe, kemi ruajtur një rregull administrativ duke cenuar qellimin për të cilin zhvillohet vetë seanca.

Çështja nuk është vetëm çfarë pajisjeje lejohet të ketë avokati në sallë. Çështja është nëse ai ka mundësi ta mbrojë realisht klientin e tij.

Pikërisht këtu reagimi i tanishëm më ngjall njëkohësisht shpresë dhe një pyetje.

Gjatë këtyre tre viteve kam kundërshtuar praktika të SPAK dhe GJKKO që i konsideroj shkelje të hapura të garancive procedurale. Nuk kam vënë re një reagim kolektiv të avokatisë të njëjtën vendosmëri ndaj tyre. Nuk po them se avokatët nuk kanë ngritur kundërshtime në çështje të veçanta. Po flas për qendrimin institucional të profesionit ndaj praktikave që prekin shume të akuzuar dhe përsëriten në shumë procese.

Le të jetë, pra, ky reagim një ogur i mirë: fillimi i një angazhimi të përbashkët jo vetëm për pengesat e drejtpërdrejta në punën e avokatit, por edhe për pengesat që e bëjnë mbrojtjen të paefektshme për klientin.

Marrim provat digjitale.

Këtu nuk jemi më përpara një fushe ku mungon jurisprudenca dhe as përpara ankesave të izoluar të disa të pandehurve apo avokatëve.

Që prej vitit 2021 ekziston vendimi njëses nr. 147 i Gjykatës së Lartë në çështjen e njohur si Lapsi.al, i cili trajtoi garancitë që duhet të shoqërojnë sekuestririmin dhe këqyrjen e të dhënave kompjuterike.

Më pas problemi ka mbërritur disa herë në Gjykatën Kushtetuese.

Në çështjen Elton Qyno, me vendimin nr. 21 të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese ndërhyri ndaj vendimeve gjyqësore që kishin lejuar sekuestririmin e të dhënave kompjuterike dhe urdheroi, sipas arsyetimit të saj, asgjësimin e të dhënave të sekuestruara.

Në çështjen Onejda Ymeraj, po në vitin 2025, Gjykata Kushtetuese bëri një dallim thelbësor ndërmjet të dhënave që lidhen me objektin e hetimit dhe atyre që nuk lidhen me të, duke kërkuar për këto të fundit asgjësimin e kopjeve dhe duke riafirmuar nevojën e kontrollit gjyqësor dhe të garancive procedurale.

Dhe seria nuk përfundon këtu.

Më 29 qershor 2026, Gjykata Kushtetuese vendosi edhe për çështjen Vladimir Vladimirov, vendim i bërë publik më 1 shtator 2026. Edhe kjo çështje kishte në qendër marrjen dhe përdorimin e të dhënave të nxjerra nga telefoni celular.

Gjykata Kushtetuese e pranoi pjesërisht kërkesën, shfuqizoi vendimin përkatës të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si të papajtueshem me Kushtetutën dhe e dërgoi çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Pra, kemi një vijë që tashmë shtrihet në disa vite:

Lapsi.al – Gjykata e Lartë, 2021. Elton Qyno – Gjykata Kushtetuese, 2025. Onejda Ymeraj – Gjykata Kushtetuese, 2025. Vladimir Vladimirov – Gjykata Kushtetuese, 2026.

Pas gjithë kësaj jurisprudence, është e vështirë që problemet që vazhdojnë të ngrihen për marrjen, këqyrjen, kopjimin, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave digjitale të konsiderohen thjesht pretendime procedurale të një të pandehuri të caktuar, të cilave mund t'u jepet përgjigjja: "do të vlerësohen gjatë gjykimit".

Këtu pikërisht shoh një rol institucional për Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

Dhoma nuk ka pse të deklarojë të paligjshme një provë konkrete dhe as të marrë rolin e gjykatës. Por, kur Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese janë detyruar vazhdimisht të ndërhyjnë mbi të njëjtën fushë problematike, avokatia ka arsye të kërkojë institucionalisht që standardet e vendosura prej tyre të respektohen që në momentin e marrjes dhe administrimit të provës.

Sepse një garanci procedurale që zbatohet vetëm pasi kanë kaluar disa vite dhe çështja ka mbërritur në Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese rrezikon të humbasë një pjesë të madhe të funksionit të saj.

Dhe këtu lind pyetja që lidhet drejtpërdrejt me reagimin e sotëm të avokatëve:

Nëse duhet një reagim en bloc kur avokatit i merret telefoni në hyrje të gjykatës, përse nuk duhet një reagim en bloc kur telefono i klientit të tij sekuestrohet, aksesohet dhe të dhënat e tij administrohen pa respektuar garancitë procedurale që jurisprudenca ka vendosur tashmë?

Kjo nuk është më vetëm çështje e telefonit të të pandehurit. Është çështje e provës mbi të cilën ai mund të akuzohet dhe gjykohej. Dhe, për këtë arsye, është edhe çështje e mbrojtjes.

Një tjetër çështje është mbajtja e të pandehurve në kafaz apo në kabina të mbyllura sigurie brenda sallës së gjyqit. Në përvojën time, arsyetimi se «të gjithë të pandehurit trajtohen njësoj në GJKKO të apelit» është përdorur si përgjigje ndaj kundërshtimit të kësaj praktike. Por një kufizim nuk bëhet i ligjshëm vetëm seose zbatohet ndaj të gjithëve. Trajtimi i njëjtë nuk e zëvendëson arsyetimin për nevojën e kufizimit.

Jurisprudence e GJEDNJ nuk ndalon automatikisht çdo kabinë xhami. Megjithatë, kërkon që kufizimet të jenë të nevojshme dhe proporcionale me rreziqet konkrete, pa cenuar pjesëmarrjen

© 2019-2025 QUINTESSENCE MEDIA GROUP

Për mua kjo nuk është çështje e organizimit të sallës. Është ceshzje nëse mund t'i tregoj menjëherë avokatit një pasaktësi, t'i kërkoj të kundërshtojë një pretendim apo të konsultohem me të pa ia bërë të dëgjueshme gjithë sallës atë që dua t'i them. Kur pengohet ky komunikim, pengohet edhe puna e avokatit. Atëherë, përse kjo të mos jetë gjithashtu një çështje e përbashkët e avokatisë?

Po aq themelor është aksesitë dosja.

Në përvojën time, marrja e materialit të fashikullit në format digjital është kushtëzuar me pagesën paraprake të një tarife. Këtu duhet bërë një dallim: një gjë është kostoja e riprodhimit të dokumentave; tjetër gjë është mundësia reale për t'u njohur me materialin mbi të cilin mbështetet akuzat.

Standardet e procesit të rregullt e lidhin aksesin të dosja me përgatitjen e mbrojtjes dhe barazinë e armëve. Ato kërkojnë gjithashtu që i akuzuari të mos pengohet në sigurimin e kopjeve të dokumenteve përkatëse dhe në përdorimin e shënimeve për mbrojtjen.

Këto nuk janë shqetësime të shkëputura të disa klientëve. Janë çështje të vetë ushtrimit të profesionit të avokatit.

Prandaj, unë nuk kërkoj më pak vendosmëri për telefonin apo kompjuterin. Kërkoj të njëjtën vendosmëri për ligjshmërinë e marrjes së provave, për aksesin në dosje dhe për komunikimin me të akuzuarin. Dhoma e Avokatisë nuk ka se si të marrë përsiper zgjidhjen e çdo çështjeje penale. Por duhet të kërkojë standarte që vlejné për të gjithë.

Gjykata, natyrisht, nuk është palë. Ajo është arbitri i paanshem mes akuzës dhe mbrojtjes. Por mbrojtja nuk mund të ndahet në dy interesa që ecin veçmas — interesin profesional të avokatit dhe të drejtën e të akuzuarit për t'u mbrojtur.

Përndryshe, rrezikojmë që në sallë të mos kemi një gjykatë përballë së cilës debatojnë akuzat dhe mbrojtja, por katër pozicione të shkëputura: Gjykata — Organi i akuzës — Avokatët — Të akuzuarit.

Artikuj te sugjeruar

NGA ILIR CIKO EDITORIAL 9 Shtator11:03

[Mbretit s'ka kush t'i shkruajë, në vetminë e tij](#)

"...sepse fiseve të dënuar me njëqind vjet vetmi nuk u jepej më asnjë shans tjetër përmbi Tokë". Kjo...

Ilir Beqaj EDITORIAL 6 Shtator11:15

[Rreziku që fshihet pas “dhuratës” së AI: Kush kontrollojnë mënyrën si mendojmë?](#)

Jam me profesion informaticien, diplomuar në 1990. Edhe pse kanë kaluar rreth dyzet vjet që kur fillova studimet dhe pjesën më të madh...

EDITORIAL 2 Shtator17:12

[Tirana është marrë peng](#)

Nga Gentian Gaba Kryeqyteti me një milion banorë është marrë peng nga brenda burgut të Durrësit, me një kryetar ba...

Ditmir Bushati EDITORIAL 2 Shtator12:31

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

Nga Ditmir Bushati NJË MOMENT VENDIMTAR PËR SHQIPËRINËSikurse shumë prej revolucioneve të Europës Lindore, protestat n...

Ilir Beqaj EDITORIAL 2 Shtator12:09

[Kufiri mes provës dhe jetës private](#)

(Nga sekuestrimi i celularit të kontrollit të jetës digjitale. Standardi që po ndërton Gjykata Kushtetuese) Deri me sot vite procedura penale e ka...

Besnik Kreka EDITORIAL 29 Gusht14:20

[Ngjitja dhe rënia e Ergys Agasit](#)

"Zhvilluam një bisedë prej gati gjysmë ore në telefon. 'Nuk të shoh në atë vend ty, nuk duhet të mërzit...

Nga Kim Mehmeti EDITORIAL 25 Gusht10:35

[Piktori duhet të bjerë që Shqipëria të mund të ngrihet](#)

A e keni vërejtur se si kanë heshtur deputetët dhe funksionarët e "Rilindjes"? Ata mbase as që i shohin protestat e rinisë...

Nga Andi Bushati EDITORIAL 17 Gusht13:50

[Pse Rama nuk tërhiqet dot nga Zvërneci](#)

Mjaftojnë qoftë dhe disa prova të vogla, gati gati të papërfillshme, për të kuptuar se platforma Besa, që Edi Rama shp...

Nga Agron Gjekmarkaj EDITORIAL 15 Gusht13:02

[Zjarret djegin Shqipërinë dhe propagandën! Si dhe një ‘sukses’ i qeverisë!](#)

Qeveria prej vitesh e ka humbur kontrollin mbi territorin. Kjo bëhet veçanërisht e dukshme në përballjen me zjarret që ç...

EDITORIAL 13 Gusht16:23

[A mund të bëhet Shqipëria një shtet më i madh sipas Marko Rubios?](#)

Nga Ben Blushi Deklarata e Sekretarit Amerikan Marko Rubio, se shtetet që nuk prodhojnë dot ilace dhe anije nuk do egzistojnë, duhet t&rsq...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 8 Shtator

[Bosi i drogës në kërkim nga SPAK filmoi në hote...](#)

Një figurë e kimit të organizuar, në kërkim nga SPAK për trafik droge, pastrim parash dhe organizatë kriminale, i niohur p&e...

AKTUALITET 8 Shtator

[EMRAT/ U qëlluan me armë zjarri, kush janë dy t...](#)

Dy persona janë plagosur me armë zjarri mbrëmjen e sotme në zonën e Laprakës në Tiranë. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur ...

BOTA 8 Shtator

[I burgosur për vrasjen e gjashtë pacientëve, ek...](#)

Luca Spada, ish-shoferi i një ambulance, i cili aktualisht ndodhet në burg nën akuzën për vrasjen e gjashtë pacientëve, dysho...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranjë jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënien të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin në autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtun “shërim” me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijëve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënua për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën "Durrës Marina" dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonom i firmaci miliona euro Vilma Nushit kjo e fundit i investoi të kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.